

Ndërtimi i familjes së lumtur

- Martesa është një begati e madhe, mirëpo përmban përgjegjësi dhe për të njeriu do të ketë llogari tek Allahu.
- Një familje e shëndetshme dhe e lumtur ndërtohet mbi baza të qëndrueshme, rrënjët e të cilave janë të ngulitura thellë në Kuran dhe sunet. Në këtë familje ka siguri, secili anëtarë ia plotëson të drejtën tjetrit, anëtarët e saj janë të lidhur fort me njëri-tjetrin, me zemra të afruara e të bashkuara, e në të kundërshtitë e mosmarrëveshjet janë të rralla etj.
- Cilat janë këto baza të cilat familjes ia sigurojnë qetësinë dhe lumturinë? Ato të gjitha merren prej Kuranit e sunetit.

1. Zgjedhja e gruas e cila është fetare, e kapur për feje.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Zgjidhe atë që është fetare! Të lumshin duart!”** E njëjta vlen edhe për gruan, të zgjedhë për bashkëshort atë burrë që është i kapur për feje. Në një hadith tjetër përmenden disa gjëra mbi të cilat qëndron lumturia e njeriut në jetën e kësaj bote, dhe të parën përmend: **“Gruaja e mirë, e devotshme”**. Kur të dy bashkëshortët janë të udhëzuar dhe janë në rrugën e

drejtë, atëherë prej kësaj do të burojë çdo mirësi, vlera të shumta, secili do t'ia plotësojë të drejtat tjetrit, jeta do të bëhet e mirë dhe e këndshme, zemrat e anëtarëve të familjes do të jenë të qeta, rehat. Një grua e tillë, është një thesar i çmuar i kësaj dunjaje. Allahu thotë në Kuran: **“Gra të mira janë ato të bindurat** (ndaj Allahut, e adhurojnë Atë, kryejnë obligimet dhe largohen nga ndalesat), **që ruajnë fshehtësitë që ka urdhëruar Allahu** (ruajnë nderin kur nuk e kanë bashkëshortin afër dhe ruajnë pasurinë e gjërat e tjera që kanë të bëjnë me jetën private).” Nisa 34. E para gjë lidhet me të drejtat ndaj Allahut, ndërsa e dyta lidhet me të drejtat ndaj bashkëshortit.

2. Njohja mirë e jetës bashkëshortore.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kërkimi i dijes fetare është obligim për secilin musliman dhe muslimane.”** Kur të dy bashkëshortët e kuptojnë jetën bashkëshortore dhe natyrën e saj brenda familjes, atëherë kjo siguron shpëtimin dhe lumturinë nga gjërat e këqija, lënduese, që prishin qetësinë shpirtërore, dhe kjo i shpëton nga mosmarrëveshjet, grindjet e polemikat e ndryshme. Dija fetare dhe edukata sheriatike i gdhend njerëzit, i edukon dhe i bën të gatshëm për të hyrë në këtë jetë të re- jetën martesore. Andaj, burri, fillimisht duhet të dijë mbi obligimet e tij karshi gruas së tij, se çfarë i lejohet e çfarë i ndalohet, të dy bashkëshortët duhen të dinë se

cili është roli i tyre në familje, se cilat janë obligimet sheriatike me të cilat ngarkohen. Nëse ndodh ndonjë mosmarrëveshje mes tyre, atëherë dija është ajo që gjen zgjedhje në këtë mes, ajo që të mëson nivelet e trajtimit të problemeve familjare. Bashkëshorti duhet të dijë ato gjëra që ndërlidhen me natyrën femërore dhe ato të cilat i shfaqen veçanërisht gjatë periudhës së ciklit menstrual (ndodh të ketë ndryshime në sjellje dhe raport).

3. Përgjegjshmëria.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Secili prej jush është çoban dhe secili është përgjegjës për kopenë e tij.”** Bashkëshortët kanë përgjegjësi të mëdha e të rëndësishme, dhe kjo përgjegjësi është pjesë e amanetit me të cilin Allahu e ka ngarkuar njeriun. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Vërtet Allahu në Ditën e Gjykimit do ta pyesë secilin njeri lidhur me atë që ka pasur nën përgjegjësi. Allahu do të të pyesë se si e ke ruajtur këtë amanet, a e ke ruajtur apo e ke humbur, madje do të pyetet njeriu edhe për anëtarët e shtëpisë së tij.”** Secili bashkëshortë ka përgjegjësitë e veta, rolin e vet në familje, dhe ata e kanë për obligim që ta kryejnë rolin e tyre. Si burri ashtu dhe gruaja do të merren në llogari për anëtarët e familjes, se a janë kujdesur për ta, a janë përpjekur për t’i përmirësuar, a kanë qenë të vëmendshëm ndaj të drejtave të tyre, a i kanë këshilluar për fenë e Allahut etj. Allahu ka thënë: **“O ju, që**

besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri...”

Tahrim 6. Nëse i kanë kryer këto përgjegjësi siç duhet le të përgëzohen me çdo të mirë, në të kundërt qysh tani duhet të fillojnë ta përmirësojnë këtë gjende. Nëse burri, bashkëshorti, ka kryer obligimet e Allahut ashtu siç duhet dhe i ka ruajtur kufijtë e Tij, po aq do ta ketë lidhjen e fortë me bashkëshorten, po aq ajo do të jetë në shërbimin e tij dhe do të kujdeset për të. Gjithashtu anasjelltas. Nëse ndodhë që në familje të ketë grindje e mosmarrëveshje, atëherë nga rrjedhë kjo? Këto gjëra vijnë nga dy anë: ose sepse bashkëshortët janë treguar të shkujdesur në ndonjërin prej obligimeve të Allahut, ose kanë kryer ndonjë gjë të ndaluar. Pa dyshim te obligimet me të cilat Allahu i ka ngarkuar, hynë të drejtat ndaj Allahut dhe të drejtat ndaj krijesave. Pra, ose kanë lënë mangët diçka në të drejtat ndaj Allahut ose ndaj krijesave, ose kanë vepruar ndonjë ndalesë. Kjo sepse mëkatet kanë ndikim të madh në prishjen e lidhjes mes bashkëshortëve dhe mes prindit e fëmijëve. Allahu thotë: **“Çdo e mirë që të gjen ty o njeri, prej Allahut është, kurse e keqja që të godet, është prej vetes sate.”** Nisa 79. Shumë bashkëshortë pyesin se nga po vijnë problemet, pse po ndodhin këto gjëra në familjet e tyre. Andaj t’i kthehemi vetëve tona e të rishikojmë se ku i kemi defektet karshi Allahut dhe karshi krijesave të Tij. Kush ruan kufijtë e Allahut, kryen obligimet dhe largohet ndaj ndalesave të Tij, dhe ruan lidhjen me Allahun, pa dyshim se Ai, si shpërblim

për këtë, do ta ruajë lidhjen mes tij dhe bashkëshortes/it dhe fëmijëve të tij.

4. Ndihma e ndërsjellë.

Allahu thotë: **“Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat...”** Maide 2. Kjo vlen edhe për bashkëshortët, pra secili prej tyre e ndihmon tjetrin, në kryerjen e punëve të mira, në çdo gjë që e do Allahu dhe është i kënaqur me të, qofshin vepra të dukshme apo të padukshme, qofshin nëse kanë të bëjnë me të drejtat e Allahut apo të krijesave. Secili anëtarë i familjes, në krye të dy bashkëshortët, e ndihmojnë njëri-tjetrin në adhurimin ndaj Allahut. Bashkëshortët ndihmohen mes vete në edukimin e fëmijëve. Kjo është barrë dhe është obligim për të dy bashkëshortët, jo vetëm për njërin. Gjithashtu ndihmohen në këshillimin ndërmjet vete. Pa dyshim, në këtë, na ka paraprirë njeriu më i mirë, ai të cilin duhet ta kemi model në pasim, shembull, e ai është Muhamedi salAllahu alejhi ue selem. Përmendet në shumë hadithe se kur ishte në shtëpi, ishte në shërbim të familjes së tij e kur vinte koha e namazit, dilte në xhami për ta falë atë.

5. Lutja ndaj Allahut.

Shumë prej bashkëshortëve tregohen të shkujdesur në lutjen drejtuar Allahut. Sa të mira ia kanë humbur vetes për shkak se kanë qenë të shkujdesur ndaj lutjes, derisa

kjo ka bërë që atyre t'iu grumbullohen problemet të cilat nuk kanë pasur mundësi t'i largojnë veçse nëse do t'i drejtoheshin Allahut me lutje. Andaj, drejtuar çdo burri e gruaja, në mënyrë që lidhja e tyre bashkëshortore të forcohet dhe zemrat e tyre të afrohen, le t'i drejtohen Allahut vazhdimisht me lutje, që Ai t'ua përmirësojë gjendjen. Allahu thotë: **“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë.”** Rum 21. Kush është Ai që i ka vendosur ato (dashurinë dhe mëshirën ndërmjet bashkëshortëve), në Dorën e Kujt janë ato? Në Dorën e Allahut dhe Ai i ka vendosur ndërmjet bashkëshortëve. Andaj, nëse na shfaqet ndonjë problem duhet t'i drejtohem Allahut në Dorën e të Cilit janë këto që u përmenden në ajet dhe t'i kërkojmë prej Tij. Lutja për anëtarët e familjes dhe bashkëshortin/en renditet në mesin e dhikrit të mëngjesit dhe të mbrëmjes, te lutja: **“O Allah, të kërkoj mirëqenie në jetën e kësaj bote dhe në ahiret! O Allah, të kërkoj falje dhe mirëqenie në fenë time, në jetën time, në familjen time dhe në pasurinë time!”** Pra, muslimani e lut Allahun që t'i japë mirëqenie në familje. Kjo mirëqenie është: shpëtimi, lumturia, dëlirësia, pastërtia.

6. Jetesa e mirë.

Allahu thotë: **“Jetoni e silluni mirë me to!”** Nisa 19. Ky është një parim i përgjithshëm. Kjo siguron

lumturinë familjare. Çfarë do të thotë të jetosh jetë të mirë me to? Kjo përfshin shumë, si: fjalën e mirë, raportin më të mirë, shprehje të buta e të mira, shoqërimin e duhur, butësinë (e cila është një prej shenjave kryesore të mirësisë në familje) etj. Një grua me emrin Esmâ erdhi te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem për ndonjë nevojë, pasi përfundoi atëherë ai e pyeti: **“A ke burrë?”** –“Po.” –**“Si është sjellja jote (raporti) me të?”** Ajo i tha: *“Unë kryej çdo obligim ndaj tij, përveç atyre gjërave që nuk kam mundësi asesi t’i kryej.”* Atëherë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem duke e këshilluar i tha: **“Shiko mirë se si është raporti yt me të. Ai është ose xheneti yt ose xhehenemi yt!”** Pra, burri do të bëhet shkak që ti të futesh në xhenet ose në zjarr. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem është pyetur: *“Cilat gra janë më të mirat?”* Dhe ka thënë: **“Ajo të cilin kur bashkëshorti i saj e shikon, (ai) gëzohet...”** Kjo do të thotë: ajo i kushton vëmendje pamjes së saj, aromës, dukjes fizike. **“...e cila i bindet burrit kur e urdhëron dhe nuk rebelohet (nuk tregohet kryeneçe) në veten e saj dhe pasurinë e saj në ato gjëra që burri i saj i urren.”** Dhe ka thënë në një hadith: **“Gratë më të mira janë ato të cilat i duan shumë burrat e tyre, që bëjnë shumë fëmijë, që nuk janë të ashpra (rebele, të rënda, por janë të bindshme), që u bëhen krahë burrave të tyre (duke u munduar t’ua lehtësojnë problemet e kësaj bote dhe duke i ndihmuar në kryerjen e veprave të mira), nëse e kanë**

frikë Allahun”, që do të thotë: ajo gjë e cila i nxitë në kryerjen e këtyre veprime është kërkimi i kënaqësisë së Allahut dhe frika ndaj Tij. Ndërsa sa i përket raportit të burrit ndaj gruas, në një hadith lexojmë: **“Më i miri prej jush është ai që është më i miri ndaj bashkëshortes së tij.”** Dhe: **“Besimtarët me besimin më të plotë janë ata me moralin (sjelljen, edukatën) më të mirë, dhe më të mirët prej jush janë ata që kanë raportet (sjelljet) më të mira me gratë e tyre.”** Po si ishte raporti i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem me gratë e tij? Ai ishte kryetar shteti, gjykatës, myfti, imam i xhamisë, mësues, komandant i ushtrive, dhe vepra të tjera të shumta të cilat ne ndoshta as sa gjysmën e tyre nuk i kemi barrë mbi supë. Megjithatë, ai sillej mirë me bashkëshortet e tij, në formën më të mirë të mundshme.

Hoxhë Petrit Perçuku - Dersi "Ndërtimi i familjes së lumtur" -
Transkriptim.

